



ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS  
KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA

Oda e Mjekëve të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: OMK) me qëllim të nderimit të mjekëve anëtar, për të arriturat e vërtetuara në fushën e mjekësisë, me kontributin e shprehur në nivel evropian dhe botëror për vitin 2023, duke u bazuar në Nenin 6 të Rregullores për dhënien e dekoratave dhe çmimeve vjetore, shpallë:

**THIRRJE PËR APLIKIM TË PËRKRAHJES FINANCIARE PËR INOVACION PËR  
VITIN 2023**

Oda e Mjekëve të Kosovës i bënë thirrje mjekëve shtetas Kosovar, anëtar të OMK të konkurojnë për përfitimin e përkrahjes financiare për arritje shkencore dhe inovacion përgjatë vitit 2023. Aplikimi për inovacion do të vlerësohet dhe përzgjedhet nga Komisioni Ad-hoc përkatës dhe më pas do të caktohet edhe shuma e përkrahjes financiare, sipas planifikimeve buxhetore të OMK-së.

**Kushtet dhe procedurat**

**Kriteret obligative të pranimit janë:**

- Mjeku shtetas Kosovar duhet të jetë anëtar i Odës së Mjekëve të Kosovës;
- Mjeku duhet të posedojë licencë valide të punës;
- Mjeku duhet të posedojë certifikatë të kaluarës etike-profesionale nga organi kompetent i OMK.

**Kriteret poentuese janë:**

- Periudha kohore e patentimit të Inovacionit duhet të jetë përgjatë vitit 2023. Inovacioni të vërtetohet me: Certifikatë apo dokument të patentës së lëshuar nga autoriteti kompetent vendor ose ndërkombëtar si në vijim:
  - a) Vendor me 4 pikë;
  - b) Evropian ose SHBA me 6 pikë;
  - c) Vendet e tjera ndërkombëtare me 4 pikë.

- Numri i konferencave ndërkombëtare (1 pikë) ose i publikimeve në revista të indeksuara në Web of Science dhe Scopus (2 pikë), të ndërlidhura me inovacionin.

**Mënyra e vlerësimit:** Totali i pikëve do të llogaritet **përmes shumëzimit** të vlerave numerike të kritereve obligative dhe selektive të lartpërmendura (\*).

*\*Nëse vlera numerike e kritereve obligative është 0 (zero), atëherë numri total i pikëve do të rezultojë me vlerë zero dhe aplikuesi do të eliminohet nga shqyrtimi.*

***Koment shesë:***

Nëse në fund të listës së aplikuesve të përzgjedhur rezulton më tepër se një aplikues me pikë të njejta, atëherë shumën e dedikuar ndahet në përpjestim të barabartë me numrin e aplikuesve.

- Një aplikues ka të drejtë aplikimi me vetëm një arritje inovacion.

Për të aplikuar, të interesuarit duhet të dërgojnë:

(I). Formularin për aplikim (e gjeni të bashkangjitur) dhe

(II). Dokumentet e lartëcekura në kriteret obligative dhe poentuese.

Dokumentet mund të dërgohen përmes e-mail adresës zyrtare të Odës: [info@omk-rks.org](mailto:info@omk-rks.org) duke shënuar në subjekt (subject) që jeni duke i'u përgjigjur thirrjes në përkrahje financiare për inovacion. Të njëjtat mund t'i dorëzoni në kopje fizike pranë zyreve të OMK-së, QKUK, Insitutet A, Kati III, 10 000, Prishtinë.

Afati për konkurim është i hapur nga data: 15 korrik 2024 deri 24 korrik 2024 në ora 16:00.

*Për sqarime dhe pyetje në lidhje me konkurimin ju lutemi drejtobuni pranë zyrës ligjore të OMK-së: [besim.ajeti@omk-rks.org](mailto:besim.ajeti@omk-rks.org) dhe [arbnore.duriqi@omk-rks.org](mailto:arbnore.duriqi@omk-rks.org) apo kontaktoni në numrin e telefonit 049-872-182.*